



SQARIM PUBLIK PËR TË INTERESUARIT

Duke marrë shkas nga disa deklaratime të bëra publike sëfundmi nga disa drejtues të pushtetit vendor dhe informacionet e përcjella për publikun në disa prej mediave audio-vizive dhe portaleve online, Korporata Elektroenergjetike Shqiptare e gjen të nevojshme të informojë publikun e interesuar mbi situatën hidroenergjetike të javës së fundit dhe të pasojave të reshjeve të shumta në veri dhe veri-lindje të vendit.

Për çdo të interesuar që dëshiron të dijë dhe të kuptojë aktivitetin dhe punën e Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare, ju sjell në vëmendje se misioni i Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare është realizimi (prodhimi dhe tregtimi) i produkteve të energjisë elektrike nëpërmjet: i) shfrytëzimit me efektivitet të burimeve hidrike, ii) mirëmbajtjes me cilësi të njëjësive të prodhimit, iii) rritjes së sigurisë dhe jetëgjatësisë së veprave, dhe e fundit, por jo për nga rëndësia, angazhimin për ruajtjen dhe përmirësimin e mjedisit, jetës dhe shëndetit të punonjësve dhe komunitetit që ndikohet prej veprimtarisë së saj.

Hidrocentralet në Kaskadën e Drinit janë ndërtuar për qëllimin primar ekonomik, atë të prodhimit të energjisë elektrike, e cila sot po mbulon nevojat e vendit, madje edhe po eksporton. Në të njëjtën kohë sjell shumë përfitime të tjera për komunitetin dhe mjedisin, pasi mundëson kontrollin dhe menaxhimin e prurjeve natyrore të Lumit Drin dhe lumenjve që e ushqejnë atë, duke reduktuar shpeshhtësinë dhe riskun e përmytjeve të zonave në rrjedhën e poshtme të Lumit Drin. Në këtë kuptim, merr rëndësi primare mbajtja dhe përmirësimi i treguesve të sigurisë së digave, kompromentimi i të cilave do të sillte pasoja fatale për popullsinë e zonës dhe ekonominë e vendit. Janë pikërisht arsytet që lidhen me sigurinë e digave, ato që përcaktojnë edhe protokollin e shkarkimeve në HEC –et e Kaskadës në kushtet e reshjeve me intensitet të lartë nga portat e shkarkimit, i cili materializohet në Rregulloren e Trajtimit të Plotave.

Gjatë ditëve 3-8 Shkurt 2018 treguesit e situatës hidroenergjetike në kaskadën e lumit Drin rezultojnë:

Treguesit	HEC Fierzë	HEC Koman	HEC Vau i Dejës
Niveli i Rezervuarit përpara fillimit të plotës (m)	289.30	168.86	73.83
Niveli i Rezervuarit më pas shuarjes së plotës (m)	292.48	172.93	75.41
Volumi i Prurjeve Natyrore në Rezervuar (milion m ³)	272.4	259.1	244.7
Volumi i Ujit Mbajtur të Rezervuar (milion m ³)	209	50.4	39.8
Volumi Total i Ujit të Shkarkuar (milion m ³)	63.4	208.7	204.9

Gjatë periudhës 3-8 Shkurt 2018 rezulton se në rezervuarët e kaskadës së lumit Drin janë rezervuar 299.2 milion m³ ujë, duke kontrolluar në maksimum prurjet në rrjedhën kryesore dhe në degëzimet e lumenjve që ushqejnë lumin Drin.

Korporata Elektroenergjetike Shqiptare vijon për të pestin vit radhazi të administrojë në dinamikë dhe me përgjegjshmëri situatat e vështira hidroenergjetike dhe të zbatojë me korrektësi protokollin e shkarkimeve bazuar në Rregulloren e Trajtimit të Plotave dhe vendimet përkatëse të Komisionit të Posaçëm të Trajtimit të Plotave.


Analiza krahasimore për menaxhimin e prurjeve në vite të ndryshme për periudha plotash të ngjajshme tregon se:

- Plota e rregjistruar në javën e parë të muajit Shkurt 2018: rezervuari i HEC Fierzë ndodhej në kuotën 291.44m dhe plota rezultoi me prurje totale natyrore prej 2,700 m³/sek (1,900 m³/sek në HEC Fierzë, 700 m³/sek në HEC Koman dhe 100 m³/sek në HEC Vau Dejës) ndërkohë që rezultoi të jenë shkarkuar 970 m³/sek nga HEC Vau Dejës apo 34% e prurjeve natyrore.
- Plota e rregjistruar në muajin Nëntor 2010: rezervuari i HEC Fierzë ndodhej në kuotën 288.9m dhe plota rezultoi me prurje totale natyrore prej 3,403 m³/sek (1,300 m³/sek në HEC Fierzë, 1,803 m³/sek në HEC Koman dhe 300 m³/sek në HEC Vau Dejës) ndërkohë që rezultoi të jenë shkarkuar 2,174 m³/sek nga HEC Vau Dejës apo 64% e prurjeve natyrore.
- Plota e rregjistruar në muajin Mars 2013: rezervuari i HEC Fierzë ndodhej në kuotën 288.88m dhe plota rezultoi me prurje totale natyrore prej 2,756 m³/sek (1,720 m³/sek në HEC Fierzë, 860 m³/sek në HEC

Koman dhe 176 m³/sek në HEC Vau Dejës) ndërkohë që rezultojnë të jenë shkarkuar 1,620 m³/sek nga HEC Vau Dejës apo 59% e prurjeve.

- Plota e regjistruar në muajin Nëntor 2016: rezervuari i HEC Fierzë ndodhet në kuotën 290.79m dhe plota rezultoi me prurje totale natyrale prej 3,170 m³/sek (2,100 m³/sek në HEC Fierzë, 870 m³/sek në HEC Koman dhe 200 m³/sek në HEC Vau Dejës) ndërkohë që rezultojnë të jenë shkarkuar 1,700 m³/sek nga HEC Vau Dejës apo 55% e prurjeve natyrale.

Për periudha me prurje të ngjashme hidrike gjatë viteve të peridhues 2010-2018, ecurina e shkarkimeve nga HEC Vau Dejës në raport me prurjet natyrale paraqitet në grafikun e mëposhtëm. Siç rezultojnë nga analiza krahasimore treguesi "shkarkime të kryera nga HEC Vau Dejës në raport me prurjet natyrale" i dy viteve të fundit rezultojnë ndjeshëm më të ulët sesa ai i viteve 2010 apo 2013.



Ndërkohë që e mirëkuptojmë shqetësimin e banorëve të Njesisë Administrative Ana e Malit, nënvizojmë se mbulimi i disa sipërfaqeve të tokave me ujë në këtë zonë, është rrjedhojë e ndërveprimit kompleks të shumë faktorëve si:

- situata e përgjithshme meteorologjike dhe intensiteti i reshjeve që ka mbuluar pjesën veriore dhe verilindore të vendit gjatë javës së parë të muajit Shkurt 2018,
- hidrologjia komplekse e bazenit Drin-Bunë,
- treguesit topografikë (lartësia mbi nivel deti) të sipërfaqes së tokës që ka prezencë uji,
- prurjet e lumenjve Gomsiqë dhe Kir (të cilat nuk kontrollohen nga KESH),
- prurjet e përroit të Shtodrit (të cilat nuk kontrollohen nga KESH)
- shkarkimeve të liqenit të Shkodrës (të cilat nuk kontrollohen nga KESH) dhe
- shkarkimeve të HEC Vau i Dejës (nën kontrollin e KESH)

Shkarkimet e kontrolluara nga HEC Vau Dejës dhe nën 50% të volumit të prurjeve natyrale flasin vetë dhe lehtësisht përgënjeshtrojnë pretendimet e palëve të ndryshme që mundohen ta paraqesin KESH sh.a. si shkaktarin e prezencës së ujit në disa zona të Njesisë Administrative Ana e Malit.

Korporata Elektroenergjitike Shqiptare, ndërkohë që konfirmon gadishmërinë e saj për bashkëpunim të frutshëm dhe bashkëveprim të kordinuar të të gjitha strukturat përkatëse të pushtetit qendror dhe lokal dhe strukturave të Emergjencave Civile sipas fushave të tyre të veprimit për t'i paraprirë çdo ngjarje potencialisht të mundshme, gjykon se çdo tentativë për "politizimin" e situatave të tilla përveç se synojnë qëllime të ngushta dhe përfitime individuale, ato nuk i shërbejnë përmbushjes së misionit të tyre në mbështetje të komunitetit dhe njëkohësisht dëmtojnë imazhin e shoqërisë KESH sh.a. si shoqëri pronë publike në shërbim të publikut dhe ekonomisë së vendit.

Pamje nga Lumi Buna dhe tokat e përmytura në të djathtë të rrjedhës në Obot të vjetër. Foto nga inspektimet e kryera ditën e shtunë (10/02/2018)



Pamje nga toka të përmytura në të djathtë të rrjedhës në Oblikë. Foto nga inspektimet e kryera ditën e shtunë (10/02/2018)

